



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 87/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 15.02.2019 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “A&T” sh.p.k në procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozim” me Nr. REF-97367-12-07-2018, me objekt: “Blerje karburant”, me fond limit 1,014,956 lekë pa TVSH, zhvilluar ne daten 24.12.2018 nga autoriteti kontraktor Ujësjiellës Kanalizime Shkodër sh.a.

Ankimues: “A&T” shpk
Adresa: Rruga “Ibrahim Rugova”, Sky Tower, kati 7/3, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Ujësjiellës – Kanalizime Shkodër sh.a
Adresa: Rruga “3 Heronjtë”, Shkodër.

Subjekte te Interesuara: “Das Oil” shpk
Adresa: Rruga “Nikolla Tupe”, Ap 4, Kati 4, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V e r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 12.12.2018 është publikuar nga autoriteti kontraktor, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit, “*Kërkesë për Propozim*” me Nr. REF-97367-12-07-2018, me objekt: “*Blerje karburanti*”, me fond limit 1,014,956 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 24.12.2018 nga autoriteti kontraktor Bashkia Lezhe.

II.2. Në datën 24.12.2018 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor me shkresën nr 80 prot, datë 24.01.2019, si dhe sistemit elektronik të prokurimeve rezulton se në datën 31.12.2018, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

1. “A&T” shpk	7.4 %	skualifikuar
2. “Das Oil” shpk	9 %	kualifikuar
3. “Arifi” shpk	9.7 %	skualifikuar
4. “Kastrati” shpk	13 %	kualifikuar

II.4. Në datën 31.12.2018, operatori ekonomik “A&T” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me arsyen se:

- Akti Teknik nga PMNZH-ja i pikës së karburantit është i pavlefshëm sepse dokumenti i paraqitur është pa firmën dhe vulën e përfaqësuesve.

II.4.1. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor me shkresën nr 80 prot, datë 24.01.2019, rezulton se në datën 07.01.2019 operatori ekonomik “A&T” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e tij në procedurën e prokurimit si më poshtë vijon:

Ne datën 31.12.2018, ora 14:35, jemi njoftuar me mesazh nepermjet sistemit elektronik te APP-se se oferta jone ne Prokurimin Publik eshte refuzuar. Ne kete mesazh rezulton se shoqeria jone A&T sh.a eshte skualifikur pasi sipas KVO-se: Akti teknik nga PMNIZH-ja i pikes se karburantit eshte i pavlefshem sepse dokumenti i paraqitur eshte pa firmen dhe vulen e perfaqesuesve. Nisur nga same lart, e bejme kete ankim pasi Shoqeria “A&T” sh.a, si Operator Ekonomik ka plotesuar te gjitha kerkesat e parashtruara me lart nga AK ne dok e tenderit, dhe parashikimeve ligjore.

- | | | | | |
|---------------------------|---|--------------|---|----------|
| 1- Shoqeria A&T sh.a | - | Oferta 7.4 % | - | Refuzuar |
| 2- Shoqeria DAS OIL shpk | - | Oferta 9 % | - | Pranuar |
| 3- Shoqeria ARIF! spk | - | Oferta 9.7 % | - | Refuzuar |
| 4- Shoqeria KASTRATI shpk | - | Oferta 13 % | - | Pranuar |

Sipas vleresimit te KVO-se se Autoritetit Kontraktor, shoqeria jone eshte vleresuar se ka plotesuar te gjithë dokumentacionin e nevojshem, por edhe pse eshte renditur e para dhe me marzhin mete ulet te fitimit eshte refuzuar si kerkese per pasoje te paqartesisë se AK ne nje dokument (Akti Teknik nga MNZ) e cila eshte leshuar nga Autoriteti Perkates “Drejtoria e Sherbimit te Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimit, Bashkia Shkoder”.

Per sa me lart, na lejoni ta kundërshtojme dhe parashtrrojme argumentat tona si me poshte:

- 1. Shoqeria A&T sh.a ka depozituar te gjithë dokumentacionin e kerkuar sipas DST ne prokurimin ne fjale, duke dhene njekohesisht edhe oferten me te mire ekonomike.*
- 2. Autoriteti Kontraktor, ne rastin ne fjale, ka gjykuar se Vertetimi i depozituar ne sistem nga ana jone, saktesisht Certifikata Nr.107 date 13.06.2018 leshuar nga DSHMZSH, Bashkia Shkoder, e Firmosur nga Inspektori i Zyres se Parandalimit Z.Gazmend Mucmeraj dhe Drejtori i Institucionit Z. Agrep Dibra, nuk i ploteson kushtet per te qene nje akt administrativ pasi nuk dallohen qarte Firma dhe vula e Institucionit.*
- 3. Sqarojme se nese AK, ka paqartesi lidhur me nje dokument te caktuar zyrtar, (Akt Admnsitrativ) te leshuar nga nje Autoritet tjetër Shteteror, mund ti drejtohet ketij te fundit nepennjet nje leter-kerkese per sqarim te paqartesisë ose mund te drejtohet vete Operatorit Ekonomik per sqarimin e dokumentacionit (sipas parashikimeve ligjore te Prokurimit Publik Neni 45 e viiues. Neni 53 e viiues i Ligjit Nr.47/201.7 i ndryshuar).*

- 4. Theksojme se Shoqeria “A&T” sh.a dhe shoqeria “OLSI” shpk, jane shoqeri te cilat jane pjesmarrese ne shume procedura te ngjashme prokurimi publik, dhe zbatojne rigorozisht te gjitha kerkesat ligjore te percaktuara ne aktet normative ne fuqi per ushtrimin e aktivitetit tregtar sipas objektit “Tregtim Karburanti”.*
- 5. Theksojme se nese do te kishte ndonje mangesi ne dokumentacionin ligjor te parashikuar nga aktet normative ligjore, Pika e Karburantit te shitjes me pakice nuk do te ishte lejuar te ushtronte aktivitetin e saj apo te pajisej me aktet e tjera normative si Vertetimi Teknik apo Analizat nga ISHTI.*
- 6. Operatori yne ekonomik, ju ka dorezuar nje dokument te vlefshem, i cili eshte leshuar nga i vetmi Autoritet Shteteror i autorizuar per ta nxjerre ate, ne perputhje me ligjin organik dhe rregullimet e tjera ligjore, por per arsye teknike mesa duket, skanimi i dokumentit ka mbetur i paqarte, dhe nuk cenohet vertetesia, legjitimiteti apo autenticiteti i Aktit Administrativ vetem per arsye teknike kompjuterike.*
- 7. Ne rast te paqartesive lidhur me aktin normativ te leshuar nga nje Autoritet shteteror ju lind e drejta per t'iu drejtuar dhe sqaruar cdo paqartesi apo interpretim te faktit Autoritetit Shteteror qe ka leshuar dokumentacionin perkates, nese ka dyshime lidhur me autenticitetin e dokumentit per sa kohe qe dokumenti ka nje numer dhe date UNIKE dhe lehtesisht te vertetueshme ose duke ju drejtuar edhe vete Operatoreve Ekonomik per sqarime lidhur me aktin administrativ.*
- 8. Per sa me siper, po ju drejtohem nepermjet kesaj ankese, duke ju bashkengjitur edhe nje kopje me te qarte te dokumentit te refuzuar ne te cilen duken qarte Firma dhe Vula e drejtuesve te Institucionit. Madje ne rast se e mendoni te arsyshme mund t'ju sjellim edhe vete origjinalin e dokumentit ose nese serish keni dyshime lidhur me autenticitetin e tij ti drejtoheni MNZSH Shkoder per te vertetuar legjitimitetin e aktit administrativ.*
- 9. Autoriteti Kontraktor, nese ka dyshime lidhur me nje dokument te leshuar nga nje Autoritet tjetër Shteteror (me numer dhe date autentike), duhet ti drejtohet fillimisht per sqarim Operatorit Ekonomik ose vete Institucionit leshues te tij, pasi ne rast te kundert do te gjendeshim ne mbivendosje te pushtetit ligjor, tejkalim te kompetencave dhe tagrave ligjore te parashikuara, cenimin e pavarsise institucionale, cenimin e transparences ligjore dhe mosdiskriminimit ne Proceduren e Prokurimit Publik, cenimit te barazise se paleve ne proces dhe sigurise juridike.*
- 10. Per sa kohe qe Oferta e dorezuar nga Bashkimi i Operatoreve “A&T” sh.a dhe “OLSI” shpk, eshte edhe oferta me e ulet ne kete procedure, dhe per sa kohe qe i gjithë dokumentacioni teknik dhe ligjor i kerkuar eshte i dorezuar dhe plotesuar i gjithi, per efekt te ligjshmerise se procesit, ekonomizimit te kontrates publike, dhe barazise se paleve ne procesin e prokurimit, kerkojme te merrni parasysh kete ankim tonin.*
- 11. Per sa me siper, ju bejme me dije se, edhe sipas Vendimeve Publike te Komisionit te Prokurimit Publik si pshmb: Vendimet te Komisionit te Prokurimit Publik nr. 236/2017, Vendimi nr. 133/2017, ose Vendimi i Komisionit te Prokurimit Publik nr. 649 date 02.10.2018, eshte mbajtur qendrimi arsyetues se: Autoriteti Kontraktor nuk mund te beje Interpretim kundershues ndaj Akteve te Autoriteteve te tjera shteterore te cilat kane te gjitha tagrat ligjore per leshimin e Vertetimeve/Raporteve/Akteve Administrative sipas percaktimeve ne ligjin organik te tyre dhe rregullimeve te tjera ligjore. Eshte detyre dhe kompetence e nje autoriteti te caktuar shteteror, sipas percaktimeve ligjore perkatese, per te prodhuar dhe nxjerre nje Akt administrativ i cili*

prodhon efekte juridike per palet e treta per sa kohe qe nuk ka nje Vendim Administrativ me te larte apo vendim gjyqesor per berjen e pavlefshme apo anullimin e ketij te fundit.

Sa me siper kerkojme nga Autoriteti Kontraktor "Sh.a Ujesjelles Kanalizime Shkoder", te marre ne konsiderate ankesen tone si dhe ne perfundim te shqyrtimit te kualifikoje shoqerine tone.

II.4.2. Në datën 11.01.2019 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr. 14/2 prot, i kthen përgjigje palës ankimuese duke vendosur refuzimin e ankesës.

II.4.3. Në datën 17.01.2019 operatori ekonomik "A&T" sh.a. ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese si në autritetin kontraktor.

II.5. Me shkresën me nr. 80 prot, datë 24.01.2019, protokolluar me tonën me nr. 81/2 prot, datë 28.01.2019, me objekt "Informacion mbi procedurën e prokurimit me objekt Blerje karburanti", është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor.

Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik "A&T" sh.a. se: "Akti Teknik nga PMNZH-ja i pikës së karburantit është i pavlefshëm sepse dokumenti i paraqitur është pa firmën dhe vulen e përfaqësuesve", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8/2 "Kriteret e vecanta të kualifikimit", pika 2.3 "Kapaciteti teknik", të dokumentave standarte të procedurës së prokurimit objekt ankimimi, rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar si më poshtë vijon:

- ❖ *Subjekti ofertues duhet të kenë në pronësi ose me qira pikë furnizimi me pakicë në qytetin e Shkodrës, vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontratë noteriale ose akt pronësie ose të jenë të pasqyruara në ekstraktin e QKR, etj) për këto stacione. Këto stacione të jenë të pajisura me leje mjedisore të tipit C, vërtetim teknik nga ISHTI, Akt-Teknik nga PMNZH, dhe Policë sigurimi në një nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, për distributorët e shitjes me pakicë.*

III.1.2. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar si më poshtë:

I- Certifikatë e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi me Nr 107, datë 13.06.2018, lëshuar nga Drejtoria Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi, Bashkia Shkodër.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1/b e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës[...].”

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

III.1.4. Në nenin 55, pika 2 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet 2. Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.

III.1.5. Në nenin 27, pika 3 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, “Kontratat e Mallrave”, parashikohet se “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

III.1.6. Në Manualin nr.1, datë 26.01.2018 “Për rregjistrimin e operatorëve ekonomikë dhe dorëzimin e ofertave në sistemin e prokurimit elektronik”, hartuar nga Agjencia e Prokurimit Publik, në faqen 17 e tij, paragrafi i parë thuhet se: “Dokumentat e skanuar duhet të jenë origjinal ose kopje e noterizuar, versioni i skanuar i këtyre dokumentave pasi hidhet në sistemin e prokurimit elektronik, për një procedurë konkrete është i barasvlefshëm me dokumentin origjinal ose kopjen e noterizuar”.

III.1.7. Në Udhëzimin e APP-së nr.3, datë 09.05.2017 “Për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Ofertave në Prokurimin me Mjete Elektronike”, i ndryshuar, parashikohet se: “Operatorit ekonomik të shpallur fitues, përpara lidhjes së kontratës, i kërkohet të paraqesë dokumentacionin administrativo ligjor në formë të shkruar të paraqitur në tender (origjinal ose fotokopje e noterizuar), i cili, verifikohet nga KVO-ja dhe bëhet pjesë e dosjes së tenderit.”

III.1.8. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit. Gjithashtu, kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik disponon dokumentacionin e nevojshëm për përmbushjen e kriterëve për kualifikim. Sa më sipër, autoriteti kontraktor, duhet të udhëhiqet nga parimi i mirëpërdorimit të fondeve publike dhe përfitimi i një produkti me cilësi të mirë dhe me çmim më të ulët, si edhe nuk duhet të gjykojë në mënyrë sipërfaqësore e formale, aq më tepër në kushte kur kemi një përcaktim të qartë të kriterëve dhe dokumentacionit që duhet të paraqitet, dokumentacion ky i cili nëse do të kishte dyshime mbi vlefshmërinë nga ana e autoritetit kontraktor në zbatim të nenit 53 pika 1 e ligjit për prokurimin publik, përcakton shprehimisht se: *“Autoriteti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave [...]., si edhe referuar VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 66, autoriteti kontraktor në rastin konkret, nëse do të kishte dyshime apo do të ishte i paqartë, kishte të drejtë që të kërkonte sqarime apo të bënte verifikimet përkatëse, në mënyrë që të bënte një vlerësim të saktë dhe trajtim të barabartë dhe jo diskriminues të operatorëve ekonomikë. Për më tepër që operatorët ekonomikë në procedurat e prokurimit ku marrin pjesë, dorëzojnë deklarata mbi përgjegjësinë që ata mbajnë për dokumentacionin që paraqesin.*

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në këtë procedurë prokurimi, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm, ndaj oferta e këtij operatori nuk duhet të ishte skualifikuar nga ana e autoritetit kontraktor. Sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

III.1.9. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, në bazë të nenit 62 *“Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës”* të LPP, autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vetë cilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje se, referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t'u siguruar nëse cilësia e mallit/shërbimit do të jetë e njëjtë me cilësinë dhe specifikimet teknike të premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë. Në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, autoriteti kontraktor zbaton

penalitetet e parashikuara në kontratë, apo detyrimet, në mbështetje të nenin 62 të LPP-së, si më sipër cituar.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “A&T” shpk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “A&T” sh.a për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozim” me Nr. REF-97367-12-07-2018, me objekt: “Blerje karburant”, me fond limit 1,014,956 lekë pa TVSH, zhvilluar ne daten 24.12.2018 nga autoriteti kontraktor Ujësjiellës Kanalizime Shkodër sh.a..
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorit ekonomik “A&T” sh.a dhe të korrigojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë ofertues.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijëni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “A&T” sh.a
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 81 Protokoli, Datë 17.01.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

NënKryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha